

IV. RAPORTIMI I DREJTORISE SE FINANCES DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të shtetit të vitit 2018 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin e detyrimeve fillestare të saj që rrjedhin nga ligji nr. 115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Ky raportim përfshin periudhën 6 mujore korrik – dhjetor 2018, për arsye se Agjencia Kombëtare e Diasporës e filloi veprimtarinë në Korrik të 2018.

Agjencisë Kombëtare të Diasporës, në mbështetje të Ligjit Nr. 109/2017, “Për Buxhetin e vitit 2018”, i ndryshuar me Aktin Normativ Nr .1 datë 26.07.2018, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 109/2017, i është akorduar fondi buxhetor prej 22.000.000 lekë.

4.1 PASQYRA E SHPENZIMEVE

Për vitin 2018 për Agjencinë Kombëtare të Diasporës është miratuar struktura e buxhetit të mëposhtëm:

Shpenzime personeli (paga dhe sigurime)	12.000.000 lekë
Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime)	4.000.000 lekë
Shpenzime kapitale për pajisje zyre dhe investime	6.000.000 lekë





Në zbatim të Aktit Normativ nr .1 datë 26.07.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018” i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Diasporës realizoi vlerën buxhetore prej 14,139,574 lekë ose 64% të fondit të planifikuar për vitin 2018.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2018, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe efektiv të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Në përfundim të vitit 2018 rezulton se shpenzimet faktike për Agjencinë Kombëtare të Diasporës janë si më poshtë:

Fondi i Pagave	2,778,866.5 lekë
Fondi i Sigurimeve Shoqërore	457,041.5 lekë
Fondi për Shpenzime Korrente	2,087,511 lekë
Fondi për Shpenzime kapitale	
për pajisje zyre elektronike dhe soft	912,840 lekë
Shpenzime kapitale për rikonstrukcion	3,815,484 lekë
Transferta	4,078,811 lekë


Buxheti i Realizuar 2018

Shpenzime për Fondin e pagave dhe sigurimeve (600,601)

Agjencia Kombëtare e Diasporës gjatë vitit 2018 ka kryer procedurat e rekrutimit, në zbatim të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij, për plotësimin e vendeve të reja të punës sipas kategorive përkatëse të miratuara.

Për vitin 2018 fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Agjencinë Kombëtare të Diasporës, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë këtij viti, numri i punonjësve u realizua deri në 12 punonjës, nga 15 punonjës të miratuar me Urdhër nr. 53, datë 16.03.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 2,778,866.5 lekë, ose 42 % e fondit të planifikuar për vitin 2018 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 457,041.5 lekë, ose 35 %, e planifikimit për periudhën respektive.

Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, 602)

Fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 2,087,511 lekë ose 52 % e fondit të planifikuar për vitin 2018. Agjencia Kombëtare e Diasporës, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë vitit 2018, në realizimin e shpenzimeve korrente, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

- Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksë e tatime.



- Realizimin e shpenzimeve për blerje materialesh e shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional.
- Realizimin e shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit, dieta, akomodim, materiale promocionale, kancelari, shërbim printimi, honorar, etj.

Meqenëse zëri shpenzime për “udhëtime jashtë vendit” zë një peshë të konsiderueshme në shpenzimet e sipër shënuara po detajojmë programin e vizitave në pasqyrën financiare të udhëtimeve si më poshtë:

4.2 PASQYRA FINANCIARE E PJESËMARRJEVE NË AKTIVITETE JASHTË VENDIT

1	Shpenzime pjesëmarrje në aktivitete						554,661
	AKTIVITETE	Pers ona	Bileta	Dieta	Shpenzime akomodimi	Tjera(Bilet e Treni, Taxi etj)	Total
1.1	Dublin, Irlandë 29 Tetor-2 Nëntor (Pjesëmarrje në vizitën e Ministrit të Shtetit Për Diasporën)	1	92,610	31,500	57,456	-	181,566
1.2	Milano, Itali 16-18 Nëntor Vatikan 19-20 Nëntor (Pjesëmarrje në vizitën e Ministrit të Shtetit Për Diasporën)	1	-	25,100	60,366	41,779	127,244
1.3	Bruksel, Belgjikë 26-27 Nëntor (Aktivitet në bashkëpunim me Neraxin në bazë të memorandumit të bashkëpunimit Nr.128, datë 20.11.2018)	2	-	21,875	-	-	21,875
1.4	Basilicata, Itali 27-29 Nëntor (Pjesëmarrje në vizitën e Ministrit të Shtetit Për Diasporën)	1	25,830	12,500	49,500	-	87,830
1.5	Romë, Itali 3-6 Dhjetor (Pjesëmarrje në vizitën e Ministrit të Shtetit Për Diasporën)	1	27,800	18,810	72,607	16,929	136,146

Fondi i shpenzime kapitale (231)





Fondi i shpenzimeve kapitale është realizuar në vlerën 4,728,324 lekë ose 79 % e fondit të planifikuar për vitin 2018. Shpenzimet kapitale për vitin 2018 të cilat u realizuan nëpërmjet procedurave të prokurimit, ishin të ndara në:

- Blerje Pajisje zyrash (printer, fotokopje, kasafortë, program financiar) 912,840 lekë
- Investim për rikonstruksion godine 3,815,484 lekë
- Realizimi i zërit "Shpenzime për pajisje zyrash" u realizua nëpërmjet procedurave të prokurimeve blerje me vlera të vogla.

Realizimi i zërit "Investime për rikonstruksion godine" u realizua nëpërmjet kontratës nr.155/2 datë 14/12/2018, lidhur me operatorin ekonomik "S.A.G" shpk, për realizimin e rikonstruksionit të vilave nr. 5 dhe 6, të cilat do të shërbejnë si zyra për administratën e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, si dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën. Procedura e prokurimit për këtë investim u realizua nëpërmjet marrëveshjes së lidhur me Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, pasi AKD nuk ka strukturat e nevojshme për kryerjen e procedurave të prokurimeve me objekt rikonstruksioni.

Zëri Transferta (604)

Në zbatim të pikës 2/b, të Vendimit nr. 611/2018, të Këshillit të Ministrave "Për financimin e projektit "Diaspora për Zhvillim" dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës" nga zëri "transferta" (604) u kalua në favor të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës shuma prej 4,078,811 lekë duke pakësuar llogarinë e shpenzimeve të personelit (600,601) në këtë masë.

Shuma prej 4,078,811 lekë, ndihmon Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për fazën fillestare të nisjes të aktivitetit dhe do të përdorej për paga dhe shpenzime.

4.3 TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI

Llog.Ek	Pershkrimi	Buxheti Plan 2018	Buxheti I Rishikuar 2018 sipas VKM 611	Buxheti I Realizuar	Buxheti I Realizuar %
600	Fond Page	10,000,000.00	6,602,350.00	2,778,886.50	42%
601	Kontrib. Sig. Shogërore & Shëndetësore	2,000,000.00	1,318,839.00	457,041.50	35%
602	Shpenzime Operative	4,000,000.00	4,000,000.00	2,087,511.00	52%
604	Transferta		4,078,811.00	4,087,811.00	100%
231	Investime	6,000,000.00	6,000,000.00	4,728,324.00	79%





I. RAPORTIMI I DREJTORISE SE FINANCES DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE


10.1 ANALIZË FINANCIARE 2019

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të shtetit të vitit 2019 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 dhe Planit të Veprimit.

Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2019, që është viti i parë i funksionimit të plotë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Në zbatim të Ligjit Nr.99/2018, “Për Buxhetin e vitit 2019”, Agjencisë Kombëtare të Diasporës i është akorduar një fond buxhetor prej 81.500.000 lekë, i cili përbëhet nga:

- | | |
|--|-----------------|
| • Shpenzime personeli (paga dhe sigurime) | 16.500.000 lekë |
| • Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime) | 65.000.000 lekë |




Në zbatim të Ligjit Nr.99/2018, “Për Buxhetin e vitit 2019”, Agjencia Kombëtare e Diasporës realizoi vlerën buxhetore prej 73,427,700 lekë.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2019, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në përfundim të vitit 2019 rezulton se shpenzimet faktike të realizuara për këtë vit, janë si më poshtë:



• Fondi i Pagave	11,158,173	lekë
• Fondi i Sigurimeve Shoqërore	1,854,189	lekë
• Fondi për Shpenzime Korrente	60,415,338	lekë



1. Shpenzime për Fondin e pagave dhe sigurimeve (600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë këtij viti, numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 13 punonjës, nga 15 punonjës të miratuar me Urdhrin nr. 53, datë 16.03.2018 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 11,158,173 lekë, ose 77 % e fondit të planifikuar për vitin 2019 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 1,854,189 lekë, ose 93 %, e planifikimit për periudhën respektive.

2. Shpenzimet Korrente(mallra dhe shërbime,602)

Fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 60,415,338 lekë ose 93 % e fondit të planifikuar për vitin 2019.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë vitit 2019, në realizimin e shpenzimeve korrente, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

- Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.



- Realizimin e shpenzimeve për blerje materiale shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional. të tilla si shpenzime për udhëtime jashtë vendit,dieta,akomodim, materiale promocionale, kancelari, shërbim printimi, honorare,etj.

Gjatë këtij viti u realizuan me sukses takime dhe aktivitete të larmishme në vende të ndryshme ku gjenden komunitete shqiptare në Diasporë. Në tabelën e mëposhtme paraqiten takimet dhe aktivitete me elementet përbërës të tyre.

TABELA E DETAJIMIT TË SHPENZIMEVE KORRENTE

Nr.	AKTIVITETET	SHPENZIMET
1	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Ukrainës	11,854,723.00
1.1	Mësimi i valleve dhe këngëve popullore në Karakurt	1,755,530
1.2	Mësimi i valleve dhe këngëve popullore në Zaporozhje	819,950
1.3	Mësimi i gjuhës shqipe në Karakurt (Mësuesit në Karakurt)	407,819
1.4	Koncert përmbyllës në Odessa(TOB)	7,813,820
1.5	Takime Praprake	1,057,604
2	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Italisë	9,724,658
2.1	Java kulturore (Simpozium në Puglia)	1,844,024
2.2	Koncert në Itali (Dy koncerte:koncert klasik në Piana dei albanesi dhe koncert i TOB)	7,537,508
2.3	Takime Paraprake	343,126
3	Aktivite për Komunitetin Shqiptar të Kroacisë	5,113,855
3.1	Mësimi i valleve ,këngëve popullore si dhe organizim i një shfaqje teatrale në Zara	709,607
3.2	Mësimi i gjuhës shqipe në Zara(Mësuesit në Zara)	451,789
3.3	Koncert klasik, përmbyllës i aktiviteteve në Zara,Kroaci	3,345,056
3.4	Takime Paraprake	607,403
4	Të njohim komunitetet tona në Diasporë	968,459
4.1	Vizitë e nxënësve shqiptarë në komunitetin shqiptar në Bullgari në bashkëpunim me ambasadën shqiptare në Sofje dhe shoqatën “Tradita Popullore”.	968,459
5	Ditët e Shqipërisë	17,451,100
5.1	Koncert I TOB në New York(Usa)	15,993,380
5.2	Simpozium “xhubleta” në Rotterdam dhe Hagë,Hollandë	1,886,520
6	Dita e Diasporës(Mbledhja e KKD)	3,646,477
7	Shpenzime të tjera (shpenzime për samitin, shpenzime administrative, shpenzime promocionale)	11,227,266
	TOTALI	60,415,338


TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI

Llog.Ek	Pershkrimi	Buxheti Plan 2019	Buxheti I Realizuar 2019	Buxheti I Realizuar %
600	Fond Page	14,500,000.00	11,158,173	77 %
601	Kontrib. Sig.Shoqerore & Shendetesore	2,000,000.00	1,854,189	93 %
602	Shpenzime Korrente	65,000,000.00	60,415,338	93 %




8. RAPORTIMI I DREJTORISË SË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të shtetit të vitit 2020 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 dhe Planit të Veprimit.

Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2020 dhe pasqyron funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës në kushtet e pandemisë covid-19, e cila në përputhje me situatën e përgjithme anticovid, rialokoi aktivitetet e miratuara nga Këshilli Drejtues, në aktivitete të tjera të realizueshme.

Bazuar në Ligjin nr. 88/2019, “Për Buxhetin e vitit 2020”, Agjencisë Kombëtare të Diasporës i është akorduar një fond buxhetor prej 81.500.000 lekë, i cili është i përbërë nga:

Shpenzime personeli (paga dhe sigurime)	16,500,000 lekë
Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime)	62,000,000 lekë
Shpenzime kapitale (investime)	3,000,000 lekë





Sipas Aktit Normativ Nr.15 datë 15.04.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin 88/2019, për Buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar” Agjencisë Kombëtare të Diasporës ju pakësuan fondet buxhetore nga zëri shpenzime korrente në vlerën 6,000,000 lekë. Si pasojë e këtij pakësimi buxheti i shpenzimeve korrente rezultoi në vlerat e mëposhtme:

shpenzime personeli(paga dhe sigurime)	16,500,000 lekë;
Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime)	56,000,000 lekë;
Shpenzime kapitale (investime)	3,000,000 lekë.

Bazuar sipas Aktit Normativ Nr.28, datë 02.07.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin 88/2019, për Buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar”, fondet buxhetore të akorduara për Agjencinë Kombëtare të Diasporës u pakësuan me vlerën 22,500,000 lekë (paga dhe sigurime shoqërore 1,500,000 lekë dhe shpenzime korrente 21,000,000 lekë)

Bazuar në Ligjin 88/2019, “Për Buxhetin e vitit 2020”, midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën, institucione të cilat bëjnë pjesë në programin buxhetor “Shërbimi për Diasporën, u realizuan transfertat e ndërsjellta si më poshtë:


Në zbatim të shkresës nr 21330/2 datë 25.11.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, buxheti i Agjencisë Kombëtare të Diasporës për shpenzime kapitale (231) u shtua me 5,000,000 lekë duke shkuar në vlerën 8,000,000 lekë, si dhe bazuar në kërkesën e miratuar të Qendrës së Botimeve për Diasporën nr. protokolli 18016/1 datë 05/10/2020 u realizua “transferta” në favor të Qendrës së Botimeve për Diasporën nëpërmjet pakësimit të llogarisë në plan buxhet (602) të Agjencisë Kombëtare të Diasporës në vlerën prej 4,859,880 lekë.



Vlerat e buxhetit rezultojnë sipas zërave më poshtë :

Shpenzime personeli (paga dhe sigurime)	15,000,000 lekë;
Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime, bursa)	30,240,120 lekë;
Shpenzime kapitale (investime)	8,000,000 lekë.
Totali	53,240,120 lekë

Buxheti 2020 pas ndryshimeve




Në zbatim të Aktit Normativ Nr.15 datë 15.04.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin 88/2019, për Buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar” dhe Aktit Normativ Nr.28, datë 02.07.2020 “Për disa ndryshime në Ligjin 88/2019, për Buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar”, Agjencia Kombëtare e Diasporës realizoi vlerën buxhetore prej 37,370,736.70 lekë.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2020, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin



Financiar dhe Kontrollin”. Në përfundim të periudhës Janar-Dhjetor 2020, rezulton se shpenzimet faktike janë realizuar si më poshtë:

Fondi i Pagave	11,659,914 lekë
Fondi i Sigurimeve Shoqërore	1,915,861 lekë
Fondi për Shpenzime Korrente	15,295,086.70 lekë
Fondi për shpenzime Kapitale	0 lekë
Transfertë MEPJ	8,499,875 lekë
Totali	37,370,736.70 lekë



i) Shpenzime për Fondin e pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 13 punonjës, nga 15 punonjës të miratuar me Urdhrin nr. 53, datë



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

16.03.2018 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës".

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 11,659,914 lekë ose 89,6 % e fondit të planifikuar për vitin 2020 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 1,915,861 lekë, ose 96 %, e planifikimit për periudhën respektive.

ii) *Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 604)*

Fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 23,794,961.7 lekë ose 79% e fondit të planifikuar për vitin 2020.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë kësaj periudhe, në realizimin e shpenzimeve korrente, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

- Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.
- Realizimin e shpenzimeve për blerje materialesh e shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional. të tilla si shpenzime për udhëtime jashtë vendit, dijeta, akomodim, materiale promocionale, kancelari, shërbim printimi, botimi, honorare, etj.
- Duke u bazuar në kërkesën e miratuar të Qendrës së Botimeve për Diasporën u realizua "transferta" në favor të Qendrës së Botimeve për Diasporën në shumën prej 4,859,880 lekë duke pakësuar llogarinë e shpenzimeve korrente në plan buxheti (llogaria 602), në këtë vlerë.
- Duke u bazuar në VKM nr.445 dt.03.06.2020 "Për një shtesë në vendimin nr.780, datë 6.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi" nga zëri transfera (llogaria 604) u kalua në favor të Ministrisë së Europës dhe Punëve të Jashtme shuma prej 8,499,875 lekë duke pakësuar llogarinë e shpenzimeve korrente në këtë vlerë.





Shënim : Në tabelën e mëposhtme paraqiten takimet, aktivitete dhe transfertat me elementet përbërës të tyre.

TABELA E DETAJIMIT TË SHPENZIMEVE KORRENTE

Nr.	AKTIVITETE DHE TRANSFERTA	SHPENZIMET/ LEKË
1.	Aktivitet për Komunitetin Shqiptar Në Greqi (koncert me këngëtarë lirikë)	3,915,709
2.	Takimi i Mjekësisë në Diasporë	444,544
3.	Shpenzime në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së Universitetit Izmalias në Ukrainë	630,226
4.	Shpenzime të tjera (shpenzime administrative, botime, printime, honorare)	10,304,606.70
5.	Transfertë MEPJ në bazë të VKM nr.445 dt.03.06.2020 “Për një shtesë në vendimin nr.780, datë 6.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi”	8,499,875
	TOTALI	23,794,961.70

iii) Shpenzime kapitale (llogaria ekonomike 231)

Llogaria ekonomike “Shpenzime kapitale” në vlerën 8,000,000 nuk u prek pasi procedura e prokurimit të bazës së të dhënave që do të krijohej në zbatim të Vendimit nr. 504, datë 24.06.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga republika e shqipërisë”, zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, nuk u realizua brenda vitit 2020.



**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**

TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT)

Llog.ck	Përshkrimi	Buxheti 2020	Buxheti i realizuar (12 mujori 2020)	Buxheti i realizuar %
600	Fond Page	13,000,000.00	11,659,914	89.6 %
601	Kontrib. Sig.Shoqërore & Shëndetësore	2,000,000.00	1,915,861	96 %
602 + 604	Shpenzime Korrente	30,240,120.00	23,794,961.7	79 %
231	Shpenzime Kapitale	8,000,000.00	0	0 %
	Total	53,240,120.00	37,370,736.70	70%



RAPORTIMI I DREJTORISË SË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të shtetit të vitit 2021 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2019-2025 dhe Planit të Veprimit.






AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2021 dhe pasqyron funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës në kushtet e pandemisë covid-19.

Bazuar në Ligjin nr. Bazuar në Ligjin nr. 137/2020“Për buxhetin e vitit 2021”, Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2021, i është akorduar fondi buxhetor prej **87,600,000(tetëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind mijë)lekë**, i detajuar si më poshtë:

Shpenzime personeli(paga dhe sigurime shoqërore)	17,600,000 lekë;
Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime,bursa)	62,000,000 lekë;
Shpenzime kapitale (investime)	8,000,000 lekë.

Gjithsej	87,600,000 lekë
-----------------	------------------------



Në vitin 2021 në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe me miratimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u realizua riallokimi i brendëshëm i fondeve buxhetore në zërin “shpenzime kapitale” në vlerën 8.000.000 lekë, duke e rritur kështu shpenzimet kapitale në vlerën 16.000.000(gjashtëmbëdhjetë milion) lekë. Ky riallokim u realizua brenda programit buxhetor “Shërbime për Diasporën”(grupi 87), nga Qendra e Botimeve për Diasporën tek Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe si pasojë fondet e përgjithshme buxhetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës u rritën në vlerën **95.600.000(nëntëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind mijë)lekë**.






Ndërsa me anë të Aktit Normativ nr.26, Datë 22.06.2021, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 137/2020“Për buxhetin e vitit 2021”, Agjencisë Kombëtare të Diasporës iu pakësuan fondet buxhetore në zërin “Shpenzime Korrente” (llogaria ekonomike 602) në vlerën 20,000,000 (njëzet milion)lekë.

Si pasojë vlerat përfundimtare të buxhetit për vitin 2021 rezultojnë si më poshtë:

Shpenzime personeli(paga dhe sigurime)	17,600,000 lekë;
Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime,bursa)	42,000,000 lekë;
Shpenzime kapitale (investime)	16,000,000 lekë.
Gjithsej	75,600,000 lekë

Buxheti 2021 pas ndryshimeve




11.1. Realizimi

Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2021, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ”. Në përfundim të vitit buxhetor Janar-Dhjetor 2021, rezulton se shpenzimet faktike janë realizuar si më poshtë:


TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT)

Llog.ek	Përshkrimi	Buxheti Plan 2021	Buxheti Fakt 2021	Buxheti i realizuar %
600	Shpenzime për Paga	15,500,000.00	12,413,473.00	80 %
601	Shpenzime për Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	2,100,000.00	2,068,801.00	99 %
602	Shpenzime Korrente	42,000,000.00	33,161,356.46	79 %
231	Shpenzime Kapitale	16,000,000.00	14,913,600.00	93%
	Gjithsej	75,600,000.00	62,557,230.46	82%



11.1.1. Shpenzime për Fondin e pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 13 punonjës, nga 15 punonjës të miratuar me Urdhrin Nr.111, Datë 10.09.2021 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të



Diasporës” e përbërë nga Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Sektori i Projekteve.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 12,413,473.00 (dymbëdhjetë million e katërqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre) lekë ose 80 % e fondit të planifikuar për vitin 2021 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 2,068,801.00 (dy milion e gjashtëdhjetë e tetë e tetëqind e një) lekë, ose 99 %, e planifikimit për periudhën respektive.

11.1.2. Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 602)

Për vitin 2021, fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 33,161,356.00 (tridhjetë e dy milion e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtë dhjetë e shtatë) lekë ose 79% e fondit të planifikuar.

Në llogarinë ekonomike 602 “shpenzime korrente” për arsye të pandemisë, nuk u realizua dhënia e bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare sipas VKM 447 dt 22.07.2021 “Për kriteret e dhenies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2021-2022”.

Agjencia Kombëtare e Diasporës në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë kësaj periudhe, në realizimin e shpenzimeve korrente, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.

Realizimin e shpenzimeve për blerje materialesh e shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional. të tilla si blerje materiale kancelarike, shërbim printimi, botimi, honorare, shërbim përkthimi etj.



Realizimin e shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit, dieta, akomodim, materiale promocionale, të nevojshme për realizimin e aktiviteteve dhe takimeve në Diasporë sipas Programit vjetor të miratuar nga Këshilli Drejtues.

11.1.3. Shpenzime kapitale (llogaria ekonomike 231)

Fondi për Shpenzime Kapitale (llog.231) me vlerë 16,000,000(gjashtëmbëdhjetë million)lekë, është realizuar në vlerën 14,913,600 (katërmëdhjetë million e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.

Llogaria ekonomike “Shpenzime kapitale” u prek në vlerën 14,913,600.00 (katërmëdhjetë milion e nëntëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë, nëpërmjet realizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore” në zbatim të Vendimit nr.504, datë 24.06.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga republika e shqipërisë”, zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për llogari të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Pjesa e mbetur e llog 231“shpenzime kapitale” është në vlerën 1,086,400.00(një million e tetëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind) lekë.



ANALIZË FINANCIARE JANAR-DHJETOR 2022

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të shtetit të vitit 2022 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2019-2025 dhe Planit të Veprimit.

Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2022 dhe pasqyron funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Në zbatim të Vendimit Nr.81, datë 09.02.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, Agjencia Kombëtare e Diasporës përfshihet në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Bazuar në shkresën 13876/2 datë 27.07.2022, Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2022, i është transferuar fondi buxhetor prej 42,568,937 (dyzet e dy milion e





pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekë, i detajuar si më poshtë:

- Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore) 11,336,846 lekë;
- Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime) 31,132,091 lekë;

Gjithsej 42,468,937 lekë

Nr.	SHPENZIMET KORRENTE	SHPENZIMET	%
1	Shpenzime Kancelarie	95,200	0.65
2	Shpenzime Bojra Printeri dhe mirembatje të paisjeve të zyrës	105,600	0.72
3	Shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit	5,000	0.03
4	Shpenzime poste	2,215	0.02
5	Shpenzime telefonike	28,107	0.19
6	Shpenzime interneti	30,000	0.20
7	Shpenzime pastrimi	240,000	1.63
8	Takim Institucional në kuadër të projektit "Startup Diaspora"	35,000	0.24
9	Takim në kuadër të festave të Nëntorit në Londër	885,198	6.02
10	Takim në kuadër të festave të Nëntorit në Mynih Gjermani	351,377	2.39
11	Dita e Diasporës		
11.1	Shpenzime akomodimi	263,700	1.79
11.2	Shpenzime pritje përcjellje (Darke e KKD me Ministren për Europën dhe Punët e Jashtme)	151,100	1.03
11.3	Darke Gala sipas marreveshjes me Dhomen e Biznesit të Diasporës	1,774,500	12.07
11.4	Dreka	139,500	0.95
11.5	Coffee Break	85,000	0.58
11.6	Ambiente në kuadër të Ditës së Diasporës (Plaza Hotel)	415,000	2.82



12	Mbështetjen Financiare të Menjëherdhme të Punonjësve të Njësive të Qeverisjes së Përgjishme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik për Zbutjen e Impaktit të Krizës	100,000	0.68
13	Mbështetje financiare për ngritjen e Qendrës Kulturore në Athinë, Greqi	10,000,000	68.00

SHPENZIME PËR FONDIN E PAGAVE DHE SIGURIMEVE (LLOGARIA EKONOMIKE 600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 10 punonjës, nga 16 punonjës të miratuar me Urdhrin Nr.111, Datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” e përbërë nga Drejtoria e Diasporës (Saktori i Diasporës dhe Saktori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Saktori i Projekteve.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 4,375,673.00 (katër million e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë nga vlera prej 9,904,046.00 (nëntë million e nëntëqind e katërmijë e dyzet e gjashtë) lekë e fondit të miratuar ose 44 % e fondit të planifikuar për vitin 2022 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 849,300 (tetëqind e dyzet e nëntë mijë e treqind) lekë, ose 59 %, e planifikimit për periudhën respektive.

SHPENZIMET KORRENTE (MALLRA DHE SHËRBIME, LLOGARIA EKONOMIKE 602)

Për vitin 2022, fondi i shpenzime korrente është realizuar në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë kësaj periudhe dhe kanë konsistuar në:



- Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.
- Realizimin e shpenzimeve për realizimin e aktivitetit të ditës së Diasporës bazuar në Vendimin Nr.320, datë. 15. 05. 2019 " Për Statusin e Anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës".
- Mbështetje financiare për ngritjen e Qendrës Kulturore në Athinë, Greqi në mbështetje të Vendimit Nr.470 date 26.07.2018 "Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrave Kulturore për Diasporen" dhe marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi.

SHPENZIME PËR MBËSHTETJE FINANCIARE (LLOGARIA EKONOMIKE 606)

Në zbatim të Vendimit nr. 898 datë 29.12.2022 “Për Mbështetjen Financiare të Menjëherdhme të Punonjësve të Njësive të Qeverisjes së Përgjishme dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik për Zbutjen e Impaktit të Krizës”, Agjencia Kombëtare e Diasporës realizoi shpenzimin e fondit rezervë në vlerën prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.





1.1. ANALIZË FINANCIARE JANAR-DHJETOR 2023


Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të vitit 2023 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2019-2025 dhe Planit të Veprimit.

Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2023 dhe pasqyron funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Bazuar në shkresën Nr.19180 Prot., datë 15.12.2022, Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2023, i është transferuar fondi buxhetor prej 85,600,000 (tetëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë, i detajuar si më poshtë:

– Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore)	17,900,000 lekë;
– Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime, bursa)	59,700,000 lekë;
– Shpenzime kapitale (investime)	8,000,000 lekë.
Gjithsej	85,600,000 lekë


Buxheti 2023





Me hyrjen në fuqi të VKM nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, fondet buxhetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës ndryshuan si më poshtë:

– Shpenzime personeli (paga dhe sigurime)	21,300,000 lekë;
– Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime, bursa)	59,700,000 lekë;
– Shpenzime kapitale (investime)	8,000,000 lekë.
– Fond i vecantë	100,000 lekë


Gjithsej
89,100,000 lekë


1.2. Realizimi

Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2023, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në përfundim të vitit buxhetor Janar-Dhjetor 2023, rezulton se shpenzimet faktike janë realizuar si më poshtë:


TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT)

Llog.ek	Përshkrimi	Buxheti Plan 2023	Buxheti Fakt 2023	Buxheti i realizuar %
600	Shpenzime për Paga	18,500,000.00	13,255,955.00	72 %
601	Shpenzime për Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	2,800,000.00	2,170,748.00	78 %
602	Shpenzime Korrente	59,700,000.00	52,047,737.00	87 %
231	Shpenzime Kapitale	8,000,000.00	-	0%
606	Fond i vecantë	100,000.00	-	0%



Në tabelën e mëposhtme paraqiten detajimi i shpenzimeve korrente me elementet përbërës të tyre.

1.2.1. për Fondin e pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 10 punonjës, nga 16 punonjës të miratuar me Urdhrin Nr.111, Datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të



Diasporës” e përbërë nga Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse si dhe Sektori i Projekteve.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 13,255,955 (trembëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e pesëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë ose 72 % e fondit të planifikuar për vitin 2023 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 2,170,748 (dy milion e njëqind e shtatëdhjetëmijë e shtatëqind e dyzet e tetë) lekë, ose 78 %, e planifikimit për periudhën respektive. Në shpenzimet më lart janë pasqyruar dhe ndryshimet e pagava sipas VKM nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”

1.2.2. Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 602)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023, fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 52,047,737 (pesëdhjetë e dy milion e dyzetë e shtatëmijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë ose 87 % e fondit të planifikuar.

Në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë kësaj periudhe, shpenzimet korrente, kanë konsistuar në:

- Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.
- Realizimin e shpenzimeve të përgjithshme si qira, shpenzime pastrimi, shpenzime interneti, shpenzime telefoni, shpenzime poste.
- Realizimin e shpenzimeve për aktivitetin e realizuar me komunitetin shqiptar në Zvicër.
- Realizimin e shpenzimeve për aktivitete të realizuara me komunitetin shqiptar, Londër.
- Realizimin e shpenzimeve për aktivitete të realizuara me komunitetin arbëresh në Kalabri dhe Siçili.



- Realizimin e shpenzimeve në aktivitetet shoqëruese për Grupet Folklorike nga Diaspora pjesëmarrëse në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës.
- Realizimin e shpenzimeve për aktivitete si Dita e Diasporës dhe Samiti I III-të I Diasporës.
- Realizimin e shpenzimeve për libra, botime për diasporën.

1.2.3. Shpenzime kapitale (llogaria ekonomike 231)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 fondi i shpenzimeve kapitale nuk është realizuar.

1.2.4. Fond i veçantë (llogaria ekonomike 606)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 fondi i vecantë nuk është përdorur nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.



ANALIZË FINANCIARE JANAR-DHJETOR 2024

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të vitit 2024 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr.120 datë 6.3.2024 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” pika IV/1, Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021-2025.


Ky raport përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2024 dhe pasqyron funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Bazuar në shkresën nr.2 Prot., datë 03.01.2024 dhe shkresën nr.11860/1 datë 12.09.2024, Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2024, i është transferuar fondi buxhetor prej 95,477,000 (nëntëdhjetë e pesë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë, i detajuar si më poshtë:

– Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore)	27,677,000 lekë;
– Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime, bursa)	59,700,000 lekë;
– Shpenzime kapitale (investime)	8,000,000 lekë.
– Fond i vecantë	100,000 lekë.

Gjithsej

95,477,000 lekë




2.1.Realizimi



Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2024, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në përfundim të vitit buxhetor Janar-Dhjetor 2024, rezulton se shpenzimet faktike janë realizuar si më poshtë:

TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT)

Llog.ek	Përshkrimi	Buxheti Plan 2023	Buxheti Fakt 2023	Buxheti i realizuar %
600	Shpenzime për Paga	23,830,000.00	17,516,084.00	74 %
601	Shpenzime për Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	3,847,000.00	2,871,045.00	75 %
602	Shpenzime Korrente	59,700,000.00	21,129,715.00	35 %
231	Shpenzime Kapitale	8,000,000.00	-	0%
606	Fond i vecantë	100,000.00	9,282.00	9%





2.1.1. Për fondin e pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 11 punonjës, nga 16 punonjës të miratuar me Urdhrin Nr.111, Datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” e përbërë nga Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Sektori i Projekteve.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 17,516,084 (shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e katër) lekë ose 74 % e fondit të planifikuar për vitin 2024 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 2,871,045 (dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e njëmijë e dyzet e pesë) lekë, ose 75 %, e planifikimit për periudhën respektive.

2.1.2. Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 602)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024, fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 21,129,715 (njëzet e një mijë e njëqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë ose 35 % e fondit të planifikuar.

Në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë kësaj periudhe, shpenzimet korrente, kanë konsistuar në:

3. Shpenzime të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.
4. Shpenzime të përgjithshme administrative.
5. Shpenzime për programin e Shkollës Verore “Jam Shqiptar”.
6. Shpenzime në kuadër të ruajtjes së kulturës dhe identitetit kombëtar (trajnim i valltarëve nga Diaspora pranë koreografëve të TOB).
7. Shpenzime në kuadër të Festivalit të Gastronomisë Shqiptare.
8. Shpenzime për mbështetjen dhe promovimin e artistëve/figurave të shquara nga Diaspora.
9. Shpenzime në kuadër të bashkëpunimit me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare.
10. Shpenzime në kuadër të Ditës së Diasporës.

6.2.3. Shpenzime kapitale (llogaria ekonomike 231)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 fondi i shpenzimeve kapitale nuk është realizuar.

**6.2.4. Fond i veçantë (Ilogaria ekonomike 606)**

Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 fondi i vecantë është përdorur për pagesat e shërbimit të komunikimeve elektronike në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673 datë 2.9.2020 “Për pajisjen me Numër Telefoni Celular të Funkionarëve Publikë”.

TABELA E BUXHETIT VITI 2025

Llog.ek	Përshkrimi	Buxheti Plan 2025
600	Shpenzime për Paga	15,000,000.00
601	Shpenzime për Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	2,500,000.00
602	Shpenzime Korrente	59,700,000.00
231	Shpenzime Kapitale	8,000,000.00
606	Fond i vecantë	100,000.00